



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES SHKUMBIN-DEVOLL**

---

**VENDIM**

Nr. 1/12 date 4.10. 2008

**Per**

**Miratim ne parim, te kerkeses per perdorim te rezervave ujore, me koncesion, per prodhim hidroenergjie, Pellgu ujembledhes te Perroit Zerec(Perrenjte e Lares,Grafshtes,Geroves),Rezervuar Zerec. Zerec. Moglice. Korce.**

Ne mbeshtetje te neneve 8 dhe 21, pika c, te ligjit Nr.8093, date 21.03.1996 "Per rezervat ujore", Udhezimit te perbashket M.M.P.A.Ujrave e M.E.T.E. nr.727 dt.7.05.07. nr.3252 dt.02.05.07, V.K.M. Nr 87 date 16/01/2008, Pika 2.8.B te vendimit Nr.3 date 19.07.2002 te KKU, "Per miratimin e rregullores te funksionimit te Keshillit te Baseneve Ujembledhes dhe Agjensive te ujit", Keshilli i Basenit Ujembledhes Shkumbin:

**VENDOSI:**

I. "Miratim ne parim" te kerkeses per perdorim te rezerves ujore, me koncesion, per prodhim hidroenergjie.

II. Prurja mesatare e burimit ujqor, kuota absolute, Pellgu ujembledhes te Perroit Zerec(Perrenjte e Lares, Grafshtes,Geroves). Zerec. Moglice.

**HEC – 1.**

Prurja mesatare respektivisht:  $Q_{1mes} = 0.202 m^3/sek.$   $Q_{1log} = 0.263 m^3/sek$   
Kuota respektivisht:  $H = 900 m.$  absolute.

**HEC – 2.**

Prurja mesatare respektivisht:  $Q_{2mes} = 0.264 m^3/sek.$   $Q_{2log} = 0.343 m^3/sek$   
Kuota respektivisht:  $H = 760 m.$  absolute.

III. A.U.B Shkumbin te jape informacionin e nevojshem cdo aplikanti, per perdorim te Rezerves ujore, mbeshtetur ne V.K.M. Nr. 27 date 19.01.2007.

IV. Uji per H.E.C do te perdoret vetem ne rastet kur nuk cenon nevojat e komunitetit per ujesjelles e ujitje.

V. Ngarkohet A.U.B Shkumbin per ndjekjen e procedurave perkatese per zbatimin e ketij vendimi.

**A.U.B SHKUMBIN  
PERGJEGJESI  
ING. Platon GANI**



**KRYETARI KESHILLIT BAsENIT  
PREFEKTI QARKUT ELBASAN  
Shefqet DELIALLISI**

